

P Z A P
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 699/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muhamrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vodosur përkitazi me ankesën e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan paraqitur për shkak te mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.11.2013, nga Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan, ne të cilën pretendohet se në vendvotimin me nr.1772e, në Magure nuk më janë shënuar votat e sakta në FPR, dëshmi kam familjaret e burrit andaj kërkoj që të rinumërohen të gjithat votat , thuhet në pretendimet e ankimore.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminare i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parashev se “*Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të registroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përpunhje me këtë ligj*”. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të

kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përbushin standarde*” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “*PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në Nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore*”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 699/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: *PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatë (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*